

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"ALBANIA POWER CORE" sh.p.k.**

Sot, me date 07/07/2022, ortaket themelues:

Fatbardh Doko, lindur në Elbasan, më 30.06.1959, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Elbasan, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal F90630170H,

Dritan Shehu, lindur në Tirane, më 01.05.1967, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal G70501129K,

Helidon Xhaferi, lindur në Vlore, më 31.01.1971, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Vlore, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal H10131063C,

Astrit Kamberi, lindur në Tirane, më 13.03.1964, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal G40313049A,

Kane vendosur te themelojne shoqërinë tregtare "ALBANIA POWER CORE" sh.p.k, me kushtet si më poshtë:

NENI 1

Statusi Juridik

Shoqëria Tregtare "ALBANIA POWER CORE" sh.p.k. është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (në vazhdim referuar si "Shoqëria"). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Ajo ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "ALBANIA POWER CORE" sh.p.k.


NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Ndërtimi, instalimi, implementimi, shfrytëzimi dhe operimi i parkut fotovoltaiq.

1



- Prodhimi dhe furnizimi i energjisë elektrike nga parku fotovoltaik.
- Importi dhe eksporti me shumice dhe pakice i te gjitha llojeve te paisjeve, materialeve dhe lendeve te para, te nevojshme per ndërtimin, instalimin, implementimin, shfrytëzimin dhe operimin e parkut fotovoltaik.
- Çdo veprimtari tjetër tregtare te lejuar me ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Elbasan, Bradashesh, Rruga Europa 00990035, Zona Kadastrale nr. 2124, prane Doko Shpk..

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 10 000 000 leke, i perbere nga 4 (kater) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 2 500 000 leke.

Ortaket e shoqërisë zoterojne kuotat si me poshte:

Fatbardh Doko zotëron 1(nje) kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 25% te tij ne vleren 2 500 000 leke.

Dritan Shehu zotëron 1(nje) kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 25% te tij ne vleren 2 500 000 leke.

Helidon Xhaferi zotëron 1(nje) kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 25% te tij ne vleren 2 500 000 leke.

Astrit Kamberi zotëron 1(nje) kuote te kapitalit themeltar te barabarte me 25% te tij ne vleren 2 500 000 leke.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total.

NENI 6

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

Organet Drejtuese

2

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "ALBANIA POWER CORE" Sh.p.k. do të jete Fatbardh Doko-, lindur në -Fier, më 30/06/1959, identifikuar nga karta e identitetit me nr. F90630170H resident në adresën Elbasan, Rruga Kadri Hoxha Nd.123; H.1, i cili zgjidhet për një periudhë një vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8 **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortaket Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


NENI 9 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10 **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi përpilohet në 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa verejtje nga Ortaket themelues.


ORTAKET THEMELUES


Fatbardh Doko


Dritan Shehu


Helidon Xhaferi


Astrit Kamberi


HELIDON XHAFERI
3